

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Self: Tërheqja e trupave amerikane nga KFOR-i do të rrezikonte paqen në Kosovë
ADRESA	https://www.koha.net/arberi/self-terheqja-e-trupave-amerikane-nga-kfor-i-do-te-rrezikont-e-paqen-ne-kosove
BURIMI	koha.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	16 shtator 2026, 02:50:16 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	15 shtator 2026, 16:25:51 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	48087ff02cf72aa1498c78f0548005906d911bf5f4da65677143e55b47f202a0
TEKSTI	a2038b7c5281839c78ed013579a48186b5a4c47a35be805d76c80b412ad7f310
PAMJA	a2d552d5c4a410280bd2a39c568dae5c83afaf2c83a689d673ac4b10d1e64fc2

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	d7f4ba2e4a739f77542359d319c9bd4f4351439a23ecdecae171c84573152eb7
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	e059d51b19570df3bab28500acd4aaa952456ce184f2a2e88bb7ab7ef9d7b2bd
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/d7f4ba2e4a739f77542359d319c9bd4f4351439a23ecdecae171c84573152eb7>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

ARBËRI

Self: Tërheqja e trupave amerikane nga KFOR-i do të rrezikonte paqen në Kosovë



15 shtator 2026 18:25

Shpërndaje në:



Klikoni këtu nëse dëshironi t'i lexoni lajmet e fundit dhe të përzgjedhura në kanalën tonë zyrtar në Viber

Kongresisti amerikan Keith Self ka deklaruar se tërheqja e trupave të SHBA-së nga KFOR-i do të përbënte kërcënim të drejtpërdrejtë për paqen ndërmjet Kosovës dhe Serbisë.

Self, i cili kryeson Nënkomisionin për Evropën në Dhomën e Përfaqësuesve, tha se prania forcave të shtetit të tij vazhdon të jetë vendimtare për sigurinë në rajon.

"KFOR-i është bastioni aktual i paqes ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Të dyja qeveritë e njohin atë si çelës për shmangien e konfliktit", deklaroi ai, në një takim të Komitetit për Punë të jashtme të Dhomës së Përfaqësuesve të Kongresit Amerikan, transmeton KosovaPress.

Sipas kongresistit republikan, anëtarësimi në NATO është elementi më i rëndësishëm për sigurinë afatgjatë të Kosovës. Deri në arritjen e këtij synimi, ai vlerësoi se misioni i KFOR-it mbetet i pazëvendësueshëm.

Self e cilësoi Kosovën si shtet të pavarur, demokratik dhe partner strategjik të Shteteve të Bashkuara.

Edhe



Arbëri • 14 maj 2026

Në SHBA dështon kushtëzimi i Greqisë për njohje të Kosovës

Ai u bëri thirrje Greqisë, Rumanisë, Sllovakisë dhe Spanjës që ta njohin pavarësinë e Kosovës. Këto janë 4 shtetet e NATO-s që vazhdojnë të mos e njohin atë.

"Është koha që vendet mosnjohëse ta pranojnë faktin se Kosova është këtu për të qëndruar", theksoi Self.

Sipas tij, qëndrimi i këtyre shteteve po e pengon integrimin e Kosovës në Aleancën Veri-Atlantike. Ai e konsideroi këtë pengesën më të madhe për stabilitetin e Ballkanit Perëndimor.

Kongresisti kujtoi se ka sponsorizuar Rezolutën 1246 të Dhomës

Futboll.

Espi e shpëton Realin nga turpi

Arbëri.

Kurti: Shqiptarët e Luginës kanë nevojë për bashkëpunim e përgjegjësi të përbashkët

Arbëri.

Hehir: Turp i madh që një gjykatë e huaj që iu imponua Kosovës t'i shpallë fajtorë figurat e UÇK-së

Futboll.

Zyrtare: Lionel Messi ftohet nga Argjentina

Kulturë.

"Lufta nën akuzë..." demaskon rishkrimin e historisë së çlirimit

Futboll.

Liverpooli eliminon Tottenhamin nga Kupa e Ligës

se Pertaqesuesve. Dokumenti mbeshtet integrimin e Kosoves ne NATO dhe forcimin e partneritetit me Shtetet e Bashkuara. Duke folur për zhvillimet politike në Kosovë, Self u bëri thirrje liderëve që të bashkëpunojnë për zgjedhjen e presidentit.

“Sfidat me të cilat përballlet Kosova brenda vendit dhe ndërkombëtarisht kërkojnë funksionimin e institucioneve, veçanërisht zgjedhjen zyrtare të presidentit”, tha ai. Self përmendi edhe vizitën e tij në Kosovë dhe në vende të tjera të Ballkanit Perëndimor. Ai tha se delegacioni kongresional kishte takuar zyrtarë, opozitarë, përfaqësues të shoqërisë civile, studentë dhe drejtues ushtarakë.

Një pjesë e vizitës ishte përqendruar në pozitën e shqiptarëve në Luginën e Preshevës. Self theksoi se mbrojtja e të drejtave të pakicave është thelbësore për stabilitetin rajonal.

Ai kërkoi lëvizje të lirë ndërmjet Serbisë, Kosovës dhe Maqedonisë së Veriut. Sipas tij, bllokimi i pikave kufitare për arsye politike është i panevojshëm dhe nxit tensione.

Kongresisti kritikoi Qeverinë e Serbisë për refuzimin e njohjes së Kosovës dhe glorifikimin e kriminelëve të luftës. Ai përmendi nderimet shtetërore të bëra gjatë funeralit të Ratko Mlladiqit, të dënuar për gjenocidin në Srebrenicë.

Edhe



Arbëri • 12 mar 2026
Kongresistë e senatorë i kërkojnë Rubios ta parandalojë kufizimin e mundshëm të trupave amerikane në Kosovë

Self paralajmëroi se lufta hibride, urrejtja dhe diskriminimi vazhdojnë të jenë të pranishme në Ballkan. Mospërgatitja për përshkallëzime të mundshme, sipas tij, mund të ketë pasoja të rënda.

Ai kërkoi që administrata amerikane të propozojë sa më shpejt ambasadorë për Kosovën dhe Maqedoninë e Veriut./KSP



Artikuj të ngjashëm



Arbëri • 8 o. më parë
NATO rikonfirmon angazhimin e palëkundur për sigurinë në Kosovë



Opinion • 3 qer 2026
Sa më parë Kosova në NATO, më shumë siguri në Ballkanin Perëndimor



Arbëri • 27 maj 2026
Kosova synon thellim partneriteti në siguri e mbrojtje me SHBA-në

KOHA

Kjo faqe kontrollohet dhe menaxhohet nga KOHA. Të gjitha materialet në të, përfshirë fotografië, janë të mbrojtura me copyright të KOHA-s dhe për to KOHA mban të drejtat e rezervuara. Materialet në këtë faqe nuk mund të përdoren për qëllime komerciale. Ndalohet kopjimi, riprodhimi, publikimi i paautorizuar qoftë origjinal apo i modifikuar në çfarëdo mënyre, pa lejen paraprake të KOHA-s. Shfrytëzimi i materialeve nga ndonjë faqe interneti a medium tjetër pa lejen e Grupit KOHA, në emër të krejt njësisë që e përbëjnë (Koha Ditore, KohaVision, Koha.net, Botimet KOHA, KOHA Print dhe ARTA), është shkelje e drejtave të autorit dhe të pronës intelektuale sipas dispozitave ligjore në fuqi. Të gjithë shkelësit e këtyre të drejtave do të ballafaqohen me ligjin.

Përkthimi i përmbajtjeve në gjuhët tjera bëhet në mënyrë automatike dhe mund të ketë gabime!

AL | EN | DE | FR | ES | GR | SR | TR | MK

Shkarkoje aplikacionin e KOHËS



Marketing
Politika e privatësisë
Kushtet e përdorimit
Udhëzimet për përdorimin e IA-së
Cilësimet e privatësisë dhe cookies

+383 (0) 38 249 105 /

Aneksi i ish-Radio Prishtinës (kati i parë) Xhorxh Bush p.n., 10000 Prishtinë



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.